

15.09.1998, pas sigurimit paraparak të lejes së policisë serbe, Bajrami e ka varrosur Ramën në varrezat e Turjakës/Turjak.

Burimet: deklarata B.K, FDH-19267; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.1.4, FDH-30924; J. Osmani, *Krimet ...*, 71.

Sadri (Hajdar) Vishaj

(31.05.1970, shqiptar nga Belegu/Beleg, komuna e Deçanit/Deçani, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Xhevat (Muharrem) Sejfiqaj

(8.05.1972, shqiptar nga Glllogjani/Glodane, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Shpetim (Sahit) Bobi

(21.06.1974, shqiptar nga Lubeniqi/Ljubenic, komuna e Pejës/Peç, i papunë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Ditën e pacaktuar në fillim të shtatorit të vitit 1998, Shpetimi, Sadriu dhe Xhevati e kanë marrë urdhrin që të shkonin në kufi me Malin e Zi, për të ndihmuar në kalimin e civilëve matanë kufirit dhe udhëtimin e tyre në Shqipëri, sepse ishin dëbuar nga forcat serbe. Në datën **11.09.1998**, në trekëndëshin kufitar Kosovë – Shqipëri – Mali i Zi, në bjeshkën **Bogiqevica [Plav, Mali i Zi]** ata u ndeshën me pjesëtarë të UJ-së. Që të tre kanë gjetur vdekjen në këtë përleshje të armatosur. Familjarët kanë mësuar nga shqiptarët e Plavës se ushtarët e UJ-së i kanë varrosur viktimat në një livadh në Plav. Por, trupat e tyre nuk janë gjetur deri më sot. Në listën e të zhdukurve të administruar nga KNKK-ja, rasti i Sadriut është i evidentuar në lëndën me numër BLG-802510-01, ai i Xhevati me numër BLG-804208-01, ndërkaq i Shpetimit BLG-804207-01.

Burimet: deklarata N.B, FDH-35297; deklarata S.V, FDH-11492; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; SHFDUÇK, *Feniksët...*, 12, 204-205; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31815; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Ilija (Dragoje) Janković

(27.01.1958, serb nga fshati Rosulë/Rosulj, komuna e Pjesë/Peç, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Ilija ka qenë pjesëtar i forcave shtesë të MPB-së që nga viti 1998. Në datën **18.09.1998**, ai u plagos rëndë në luftimet me pjesëtarët e UÇK-së në **Baran**. Po atë ditë, e kanë transferuar në AMU në Beograd ku, një ditë më vonë, ndërroi jetë nga plagët vdekjeprurëse.

Burimet: KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 939; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 30; Z. Stijović, *Kosmet...*, 110; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.2.3, FDH-30902; *Pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme – viktimat e terrorizmit shqiptar në vitin 1998*, <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078.

Rexhep (Ramiz) Kaliqani

(2.02.1944, shqiptar nga Peja/Peç, ekonomist, katër fëmijë)

Rexhepi me bashkëshorten Sabrijen dhe katër vajza kanë banuar në qendër të qytetit të **Pejës/Peç**, E kishin banesën në ndërtesën që gjendej në Rrugën *Marshall Tito*. Në datën **20.09.1998**, Rexhepi doli nga banesa, por nuk u tha familjarëve ku po shkonte. Nga ajo ditë, kurrë më nuk e kanë parë. Fati i tij ishte i panjohur deri më 1.02.2003, kur përfaqësuesit e KNKK-së e kanë njoftuar familjen se mbetjet mortore të Rexhepit ishin gjetur në Irzniq/Rzniç. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Rexhepit në varrezat e Pejës/Peç më 5.12.2003.

Burimet: deklarata S.K, FDH-14315; OMPF, *Regjistri i konsoliduar...*, FDH-32367.

Nuradin (Cekë) Zejnullahu

(29.05.1949, shqiptar nga Peja/Peç, mjek internist, katër fëmijë)

Nuradini me fëmijët jetonin në shtëpinë familjare në Rrugën *Lidhja e Prizrenit*, në afërsi të gjimnazit në **Pejë/Peç**. Në datën **18.11.1998**, rreth orës 20:30, dy burra të maskuar dhe të armatosur erdhën te shtëpia e tij. Të birit të Nuradinit, i cili në atë çast po hynte në shtëpi, i thanë që ta thërriste babanë. Kur Nuredini doli jashtë, ata hapën zjarr dhe e qëlluan në këmbë. Pastaj, u larguan. I vëllai i Nuredinit e ka çuar menjëherë atë në spitalin e qytetit, ku Nuredini iu nënshtua intervenimit kirurgjikal. Për shkak të gjendjes së rëndë, e nisën për në spitalin e Prishtinës/Priştina,